



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:126806

Datë: 14.02.2025

Numri i dokumentit: 06853141

P.nr.492/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurve A.F. nga Vushtrria, D.M. nga Vushtrria dhe SH.G. nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Vjedhja e rëndë* nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.229/14 e datës 16.12.2016, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor e publik të mbajtur me datë 06.02.2025, në të cilin ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla, i dëmtuari Xh.S., i pandehuri A.F. me mbrojtësin av.Kushtrim Salihu, i pandehuri D.M. me mbrojtësin av.Abit Asllani dhe i pandehuri SH.G. me mbrojtësin e tij av.Irfan Zushi si dhe dëshmitaret Sh.S., F.B. dhe A.M., me datë 06.02.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 14.02.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. I PANDEHURI: A.F. nga i ati F..., e ëma K..., e gjinisë Q..., data e lindjes.. në Vushtrri, ku edhe tani jeton në rr.“...”, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

II. I PANDEHURI: D.M. nga i ati J..., e ëma M..., e gjinisë L..., data e lindjes... në Vushtrri, ku edhe tani jeton në rr. “...”, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i gjykuar.

III. I PANDEHURI: Sh. G. nga i ati F..., e ëma A..., e gjinisë B..., data e lindjes... në Zvicër ndërsa tani jeton në fshatin ..., komuna e Vushtrrisë, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, i martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i gjykuar.

JANË FAJTORE

SEPSE: Me datë 08.04.2013, rreth orës 07:46, në lokalin D.P.T “Drini” i cili gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Vushtrri, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, kanë marr pasurinë e personit tjetër, ashtu që më forcë kanë hyrë në lokal nga ana e prapme e lokalit, duke e shfrytëzuar pullazin e një lokali për të arritur deri tek dritarja e pasme e lokalit, ku me forcë kanë hapur dritaren dhe kanë hyrë brenda, pastaj nga kati II – të kanë zbritë në lokal dhe kanë marr 113 – 118 palë patika origjinale me markës “Adidas” dhe “Rebook” në vlerë të përgjithshëm prej 7.630 euro, pastaj i kanë ngarkuar në automjetin “Reno Clio” pronë e të pandehurit SH.G., i cili patikat e vendosura në një thes i ka dërguar në shtëpinë e tij në fshatin Studime,

- Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale *Vjedhja e rëndë* nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 31, 33, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71, 72, 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449, 452 dhe 460 të KPPK-së, i

G J Y K O N

I. Të pandehurit të parë: A.F. për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjete (18) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne periudhën verifikuese në kohëzgjatje dy (2) viteve, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej dymijë e pesëqind (2,500) euro i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Të pandehurit të dytë: D.M. për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjete (18) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne periudhën verifikuese në kohëzgjatje dy (2) viteve, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej dymijë e pesëqind (2,500) euro i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Të pandehurit të tretë Sh.G.për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjete (18) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale ne periudhën verifikuese në kohëzgjatje dy (2) viteve, si dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej dymijë e pesëqind (2,500) euro i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se të pandehurit A.F., D.M. dhe Sh.G.refuzojnë të paguajnë këtë dënim me gjobë ose nuk mundën, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurve secilit veç e veç për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHEN tre të pandehurit në mënyrë të barabartë që të kompensojnë dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar Xh.S. në shumë prej shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjet euro (7,630 €), dhe atë

secili veç e veç në shumën prej dymijë e pesëqind e dyzet e tre euro e tridhjetë e tre cent (2.543.33), jo më vonë se 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

DETYROHEN të pandehurit secili veç e veç që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajnë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej njëqind euro (200€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.229/14 e datës 16.12.2016, kundër të pandehurve A.F. nga Vushtrria, D.M. nga Vushtrria dhe SH.G. nga fshati ..., komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale *Vjedhja e rëndë* nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurve lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 06.02.2025, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të njëjtëve i ofron mundësinë e deklaramit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri i parë A.F. e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës duke shtuar se i vjen keq për atë që ka ndodhur, duke i premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë më vepra penale, është i martuar, tashmë ka ndërtuar familjen dhe është prind i një fëmije, jeton jashtë vendit dhe është i gatshëm të kompensoj pjesën e dëmit ashtu si është e përcaktuar në aktakuzë, po ashtu i pandehuri i dytë D.M. e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, duke shtuar se i vjen keq për atë që ka ndodhur dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë më vepra penale, është i martuar dhe është i gatshëm të kompensoj pjesën e dëmit ashtu siç është e përcaktuar në aktakuzë, gjithashtu i pandehuri i tretë SH.G. e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, duke shtuar se i vjen keq për atë që ka ndodhur dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë më vepra penale, është i martuar, e ka ndërtuar familjen dhe tashmë jeton jashtë vendit është i gatshëm që të kompensoj pjesën e dëmit ashtu siç është e përcaktuar në aktakuzë.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve i ka propozuar gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bere nga tre të pandehurit për shkak se deklarimi i tyre gjen mbështetje në provat që e mbështesin në tërësi aktakuzën e prokurorisë si dhe po ashtu është bere pasi që të njëjtit janë njoftuar nga gjykata për benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë e po ashtu pas konsultimeve të mjaftueshme të bëra me të mbrojturit e tyre. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se si rrethanë rënduese duhet të merret faktin se vepra penale është kryere në bash kryerje e që në rastin konkret paraqet formë të bashkëpunimit dhe tregon shkallë të lartë të përgatitjes në raport me rrezikshmërinë që paraqet kjo vepër penale ndërsa rrethana lehtësuese sa i përket të tre të pandehurve prokuroria nuk gjen. Po ashtu gjykatës i ka propozuar që të shqiptojë dënimi plotësues – urdhëri për kompensimin e dëmit meqenëse të tre pandehurit

e kanë pranuar në tërësi aktakuzën respektivisht gjendjen faktike ku është përcaktuar edhe vlera e dëmit në shumën prej shtatë mijë e gjashtë qind e tridhjetë euro (7,630).

Pala e dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurores së shtetit, e po ashtu në tërësi e ka mbështetur fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit.

Avokati mbrojtës i të pandehurit të parë av.Kushtrim Salihu lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë ashtu që i propozon gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij. Ndërsa në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të merre për bazë pranimin e fajësisë, kohën kur ka ndodhur rasti pasi që kanë kaluar më tepër se njëmbëdhjetë (11) vite, të merre si rrethanë lehtësuese fakti se i njëjti është mbajtës i familjes, ka shprehur gatishmëri të kompensojë dëmin e shkaktuar, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale.

Avokati mbrojtës i të pandehurit të dytë av.Abit Asllani lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë ashtu që i propozon gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij. Ndërsa në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të merre për bazë pranimin e fajësisë, kohën kur ka ndodhur rasti pasi që kanë kaluar më tepër se njëmbëdhjetë (11) vite, të merre si rrethanë lehtësuese fakti se i njëjti është mbajtës i familjes, ka shprehur gatishmëri të kompensojë dëmin e shkaktuar, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale.

Avokati mbrojtës i të pandehurit të tretë av.Irfan Zushi lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë ashtu që i propozojë gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij. Ndërsa në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të merre për bazë pranimin e fajësisë, kohën kur ka ndodhur rasti pasi që kanë kaluar më tepër se njëmbëdhjetë (11) vite, të merre si rrethanë lehtësuese fakti se i njëjti është mbajtës i familjes, ka shprehur gatishmëri të kompensojë dëmin e shkaktuar, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale.

Tre të pandehurit janë pajtuar në tërësi me fjalët përfundimtare të avokatëve mbrojtës pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga gjykata.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurve, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar

se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të njëjtit, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: procesverbali i marrjes se deklaratës në procedurë paraprake për të pandehurin D.M. të dhënë në polici më dt.16.02.2016 dhe në prokurori më datë 08.12.2016, procesverbali i marrjes se deklaratës në procedurë paraprake për të pandehurit SH.G. të dhënë në prokurori më dt.20.10.2016, procesverbal i marrjes në pyetje për të pandehurin të dhënë në prokurori, procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitarit E.R. të dhënë në prokurori më datë 16.12.2016, procesverbal i marrjes në pyetje të dëshmitarit – dëmtuarit Xh.S. të dhënë në prokurori më datë 03.07.2015, deklarata e dëshmitarit F.B. të dhënë në polici i dt.02.09.2014, deklarata e dëshmitarit A.M. e dhënë në polici më dt.02.09.2014, deklarata e dëshmitares Donika Selaci e dhënë në polici e dt.08.08.2014, deklarata e dëshmitarit E.S. e dhënë në polici, raportet policore sipas kallëzimit penal 2014-BI-168 të datës 11.09.2014, lista e punës në depo DPT “Dini”, fatura tatimore e mallit e datës 15.04.2013, fatura e mallit e datës 02.04.2013, regjistrat e mallit, faturat tatimore të datës 18.03.2013 deri më datë 04.03.2012, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes i datës 08.04.2013, skica e vendit të ngjarjes, vështrimi i foto dokumentacionit të hetimit, si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose ndonjë gabim faktik.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se të pandehurit A.F., D.M. dhe Sh.G.kanë kryer me dashje veprën penale *Vjedhja e rëndë* nga neni 327 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 327 par.1 pika.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale *Vjedhja e rëndë* e kryen “ *Kushdo që kryen vjedhje nga paragrafi 1. i nenit 325 të këtij Kodi, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet*”, ndërsa në pikën 1.1 është e përcaktuar se “*Vepra është kryer duke thyer, kaluar apo depërtuar me forcë në veturat e mbyllura, ndërtesat, dhomat, arkat, sanduqet apo hapësirat tjera të mbyllura ose duke hequr pengesat tjera me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme*”.

Me nenin 31 të KPRK-së është përcaktuar definicioni i bashkëpunimit për kryerjen e veprës penale ku parashihet se “*Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurit A.F., D.M. dhe SH.G. ti shpall fajtor për kryerjen e veprës penale *Vjedhja e rëndë* nga neni 327 par.1 pika.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtëve përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën janë edhe penalisht përgjegjës.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht ka aplikuar dispozitat e nenit 49 par 2 të

KPRK-së e lidhur me dispozitat e zbutjes së dënimit ashti siç është përcaktuar me nenin 71 paragrafi 1 nën par 1.3 të KPRK-së.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Gjykata, lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit të parë A.F., bazuar në nenin 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marr pranimin e fajësisë nga ana e tij, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, faktin se i njëjti është mbajtës i familje si dhe po ashtu ka shprehur gatishmërinë e tij që ta kompensoj dëmin e shkaktuar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, shkallen e lartë të dashjes pasi që bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit ndërmjet të pandehurve tregon një shkallë më të lartë të përgatitjes së veprës penale, mosbashkëpunimin e tij me gjykatën për arsye së në disa raste ka munguar në seancat e caktuara nga gjykata deri në shqiptimin e masës së dorëzarisë, përkatësisht i njëjti nuk i është bindur thirrjeve dhe urdhrave të gjykatës në raport me seancat e caktuara, kjo pasi që gjykata ndaj tij me datë 07.04.2023 ka lëshuar urdhër arrest me qëllim të sigurimit të prezencës së të njëjtit.

Gjykata, lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit të dytë D.M., bazuar në nenin 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethanë posaçërisht lehtësuese lidhur me të pandehurin e dytë ka marr pranimin e fajësisë nga ana e tij, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, faktin se i njëjti është mbajtës i familje si dhe po ashtu ka shprehur gatishmërinë e tij që ta kompensoj dëmin e shkaktuar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, shkallen e lartë të dashjes pasi që bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit ndërmjet të pandehurve tregon një shkallë më të lartë të përgatitjes së veprës penale, mosbashkëpunimin e tij me gjykatën për arsye së në disa raste ka munguar në seancat e caktuara nga gjykata deri në shqiptimin e masës së dorëzarisë, përkatësisht i njëjti nuk i është bindur thirrjeve dhe urdhrave të gjykatës në raport me seancat e caktuara, kjo pasi që gjykata ndaj tij ka lëshuar urdhër arrest me datë 30.03.2015, dt.09.01.2022, dt 15.02.2022, dt. 13.07.2022, dt.09.11.2022, dt.23.02.2023, dt.07.04.2023, me qëllim të sigurimit të prezencës së të njëjtit, si dhe shtuar faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i gjykuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri P.nr.127/2018 i plotfuqishëm me datë 22.11.2018.

Gjykata, lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit e tretë Shpetim Gërxhaliu, bazuar në nenin 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethanë posaçërisht lehtësuese lidhur me të pandehurin e tretë ka marr pranimin e fajësisë nga ana e tij, ndërsa si rrethana lehtësuese ka vlerësuar premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, faktin se i njëjti është mbajtës i familje si dhe po

ashtu ka shprehur gatishmërinë e tij që ta kompensoj dëmin e shkaktuar, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, shkallen e lartë të dashjes pasi që bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit ndërmjet të pandehurve tregon një shkallë më të lartë të përgatitjes së veprës penale, mosbashkëpunimin e tij me gjykatën për arsye së në disa raste ka munguar në seancat e caktuara përkatësisht i njëjti nuk i është bindur thirrjeve dhe urdhrave të gjykatës në raport me seancat e caktuara, kjo pasi që gjykata ndaj tij me datë dhe dt.15.02.2022 ka lëshuar urdhër arrest, me qëllim të sigurimit të prezencës së të njëjtit si dhe shtuar faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i gjykuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri P.nr.157/2016 i plotfuqishëm me datë 12.09.2017.

Sipas bindjes së gjykatës, për të pandehurin A.F. dënimi me burg në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjete (18) muaj i nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe dënimi me gjobë në shumën prej dymijë e pesëqind (2,500) euro cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, për të pandehurin D.M. dënimi me burg në kohëzgjatje prej (18) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe dënimi me gjobë në shumën prej dymijë e pesëqind (2,500) euro i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa për të pandehurin e tretë SH.G. dënimi me burg në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjete (18) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe dënimi me gjobë në shumën prej dymijë e pesëqind (2,500) euro i cili dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjete (15) ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, gjykata ka vlerësuar se këto dënime janë të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë për secilin të pandehur veç e veç.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurve do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtëve nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht ka aplikuar dispozitat e nenit 49 par 2 të KPRK-së e lidhur me dispozitat e zbutjes së dënimit ashti siç është përcaktuar me nenin 71 paragrafi 1 nën par 1.3 të KPRK-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin mbi kompensimin e dëmit gjykata e mori në bazë të nenit 61 par.1 të KPRK-së, ku është përcaktuar se “Kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo vepre penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale”.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPRK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga çka u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.492/2016, datë 14.02.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.